



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1092 Prot.

Tiranë, më 5.8 2019

VENDIM Nr. 194, datë 31.07.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9, datë 31.07.2019, pasi shqyrtoi konceptin e realizimit të sondazheve dhe gërmimeve arkeologjike në kuadër të Projektit të ndërtimit të rrugës hyrëse që do të lidhë By-passin *"Fier-Levan"* me Parkun Arkeologjik të Apolonisë-subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe studimi tomografik i gjurmës së rrugës, të paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k,

VENDOSI:

1. Të miratojë konceptin e realizimit të sondazheve arkeologjike në konsultim me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik në lidhje me pozicionimin e tyre në raport me rrugën hyrëse.
2. Subjekti ARRSH duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjektin AD-STAR sh.p.k, i cili duhet të kryejë sondazhet arkeologjike për projektin e sipërcituar, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Raporti me rezultatet e sondazheve arkeologjike të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në mbledhjen e radhës së KKA.
4. Subjekti AD-STAR sh.p.k duhet të depozitojë pranë Sekretarisë Teknike një koncept gërmimi arkeologjik shpëtimi për këtë projekt sipas sugjerimeve të KKA.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO